

KRIZA E KONFIDENCËS

Shkaqet Prapa Hemoragjisë së Depozitave Bankare

Korrik 2002

Nga Dr. Shkëlqim Cani & Ilir Vika

Përmbajtja:

I. Hyrje

II. Retrospekt në Krizën e Periudhës 1996-1997

- Ecuria makroekonomike mbas tranzicionit
- Skemat piramidale *versus* sistemit bankar

III. Hemoragjia e Depozitave Bankare në Mars 2002

- Një shikim i shpejtë në kushtet e tanishme makroekonomike
- Ecuria e sektorit bankar: nevoja për reforma
- Shkaqet dhe pasojat e rrjedhjes së depozitave: kriza e konfidencës

IV. Vërejtjet Përfundimtare

I. HYRJE

Megjithëse tranzicioni i Shqipërisë në ekonominë e tregut ishte i vrullshëm dhe deri-diku i suksesshëm, themelet ekonomike të tij mbeten akoma të lëkundshme dhe jo të qëndrueshme. Sistemi financiar është, gjithashtu, i ekspozuar dhe i pambrojtur ndaj faktorëve të jashtëm. Pavarësisht faktit se ekonomia, në pjesën më të madhe, ka njohur periudha të gjata ekuilibri, përsëri ajo pësoi një krizë të thellë që ishte kryesisht rrjedhojë e një fenomeni të pastër financiar. Në të njëjtën mënyrë, hija e zezë e vitit 1997 u kthye përsëri këtë vit në mars dhe prill, por ndryshe nga pesë vite më parë këtë herë paniku pushtoi sistemin bankar. Çuditërisht, paniku bankar ndodhi në një kohë kur situata financiare e sistemit bankar vlerësohej të ishte më e mira në dhjetë vitet e fundit. Frika e një falimentimi të mundshëm të bankës më të madhe u përhap edhe në bankat e tjera, duke rezultuar në tërheqje të mëdha të depozitave nga sistemi bankar. Kriza e konfidencës që shpërtheu në vazhdim të procesit të privatizimit të bankës me pronësi shtetërore vazhdoi të thellohej më shumë se çdokush kishte parashikuar.

Ky material përqipet të analizojë shkaqet që çuan në humbjen e konfidencës së depozituesve në dy bankat më të mëdha, dhe bën gjithashtu një krahasim me krizën financiare të Shqipërisë më 1997.

Në seksionin II ne do të hedhim shikimin në ecurinë makroekonomike mbas tranzicionit, pastaj do të përqipemi të shqyrtojmë arsyet themelore që sollën ngritjen e skemave piramidale dhe të bëjmë një dallim ndërmjet skemave dhe sektorit bankar.

Seksioni III fillon me një shikim të përgjithshëm mbi sistemin financiar shqiptar të tanishëm. Meqenëse stabiliteti makroekonomik konsiderohet si një para-kusht i rëndësishëm për shëndetin bankar, ne do të hedhim një vështrim të shpejtë në kushtet makroekonomike pas vitit 1997, dhe pastaj do të ekzaminojmë të dhënat nga raportet financiare të bankave, veçanërisht kapitalin bankar, cilësinë e asetëve, fitimet, dhe treguesit e likuiditetit për të bërë një vlerësim të ecurisë së sektorit bankar dhe të shohim se cilat mund të jenë disa nga problemet dhe sfidat e sektorit. Në fund të seksionit ne do të përqipemi të japim shpjegime rreth disa prej faktorëve të mundshëm që çuan në shpërthimin e krizës së konfidencës dhe tërheqjes së depozitave.

II. RETROSPEKTIVË NË KRIZËN E PERIUDHËS 1996-1997

Ecuria Makroekonomike mbas Tranzicionit

Kur Shqipëria filloi tranzicionin e saj në ekonominë e tregut më 1991, askush nuk e priste që procesi të kalohej me aq dhimbje. Njerëzit kujtonin se procesi demokratik do të merrte "vetëm disa ditë dhe jo vite" dhe prisnin që prodhimi dhe punësimi të përmirësoheshin e të stabilizoheshin shpejt. Por, rregullimi ndodhi të ishte shumë më i ashpër sesa kishin parashikuar ata. PBB u

kontraktua më tepër se 40 për qind ndërmjet 1990 dhe 1992 përpara se ai të arrinte pikën më të ulët të tij. Por pastaj, disa masa të shpejta u ndërmorën, të tilla si mbështetja me subvencione për ndërmarrjet shtetërore, liberalizimi i shumicës së çmimeve të konsumit, liberalizimi i llogarisë korente, privatizimi i tokës dhe i ndërmarrjeve publike, reformat në një administratë shtetërore të mbingarkuar etj., të cilat krijuan hapësirat e nevojshme për progresin në konsolidimin makroekonomik në vitet e ardhshme. Ekonomia mori të ngrihej përsëri dy vite mbas vënies në punë të një programi stabilizimi. PBB reale u përmirësua dhe u rrit rreth 9 për qind në katër vitet pasuese, midis 1993 dhe 1996 (shih Tablelën në faqen 9).

Reformat ekonomike ishin të rëndësishme në vitet e para të tranzicionit. Privatizimi i tokës bujqësore dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) shtetërore hapën rrugën për emergjencën e sektorit privat. Inflacioni ra përgjatë viteve pasi deficitit fiskal ishte ulur nga 44 për qind e PBB-së në vitin 1992 në 9 për qind në vitin 1994; financimi i jashtëm në shkallë të madhe – që konsistonte në ndihmat e huaja dhe në transfertat nga shqiptarët që punojnë jashtë – ndihmuan në stabilizimin e kursit valutor. Gjithashtu, për të mbrojtur paranë vendase, banka qendrore kishte vendosur një normë interesi dysHEME mbi depozitat me afat për bankat shtetërore për mbajtjen e normave pozitive në terma realë, për pasojë nga mesi i vitit 1993 e më tej ato ishin vazhdimisht sipër normës së inflacionit.

Fundi i vitit 1995 dukej shumë optimist: rritja e prodhimit ishte 13.4 për qind, një normë inflacioni njëshifrore prej 6 për qind, një rritje në rezervat valutore, oportunitete më të larta punësimi, leku i qëndrueshëm, më pak ndërhyrje e shtetit në ekonomi, lehtësimi i lëvizjes së kapitalit etj.. Stabilizimi dhe reformat strukturore, të dyja, dhe veçanërisht liberalizimi i çmimeve dhe privatizimi i NVM, kontribuan në rritje, që nënkuptonte se, sa më shpejt të zhvilloheshin reformat aq më e vrullshme do të ishte rritja ekonomike. Përfundimisht, emigrimi i gjerë ka luajtur një rol të rëndësishëm në financimin e investimeve private, duke lehtësuar presionet mbi papunësinë dhe duke i ardhur në ndihmë buxhetit fiskal në shpenzimet sociale, gjatë gjithë procesit të zhvillimit.

Megjithatë, rritja e suksesshme u ndërpre vetëm disa muaj pas zgjedhjeve më 1996. Fushatat elektorale patën një ndikim të madh mbi politikën fiskale, duke bërë që deficitit buxhetor të ngjitej nga 9 për qind në vitin 1994 në rreth 13 për qind të PBB-së në vitin 1996, duke penguar progresin drejt stabilitetit ekonomik gjatë viteve të mëparshme. Deficiti u rrit pjesërisht për shkak të një rënijeje të të ardhurave nga taksat mbi produktet e importuara të naftës – të cilat ishin ndihmuar nga embargoja e Kombeve të Bashkuara kundër Jugosllavisë që u hoq më 1995 me mbarimin e luftës në Bosnje – dhe pjesërisht nga lëshimet në mbledhjen e taksave përpara zgjedhjeve në mes të vitit 1996. Zgjerimi i pozitës fiskale i deficitit buxhetor kontribuoi në rritjen e inflacionit në 17.4 për qind, që ishte një rritje tre herë më e madhe se ajo në vitin 1995. Nga viti 1996, shqiptarët ndoshta kishin harruar dekadat e tyre të kaluara në skamje ekstreme, dhe iluzionet e akumulimit të pasurisë në firmat

piramidale nxitën nivele më të larta të konsumit e, gjithashtu, të të mirave luksoze, mbasi njerëzit besonin të ishin në gjendje më të mirë sesa në të vërtetë ishin. Si rezultat i kërkesës së rritur për të mira dhe para, importet u rritën me 35 për qind por që u përballuan nga hyrjet e transfertave private pasi emigrantët shqiptarë investuan në firmat piramidale, duke zvogëluar kështu deficitin në llogarinë korente në 9.1 për qind të PBB-së.

Rënia njëra pas tjetrës e piramidave pritej të shoqërohej me urrejtje armiqësore – po të konsiderojmë përfshirjen e madhe të popullatës në to – por jo me të tilla shkatërrime dhe ndarje antagoniste të shoqërisë.

Në pak fjalë, përpjekjet e mira të stabilizimit u hodhën mënjanë. Përmirësimi ekonomik në gjysmën e parë të viteve '90 nuk u mbrojt të vazhdonte më tej dhe Shqipëria shpesh nuk arriti të ndiqte politikat e duhura sepse i mungonte ekspertiza e nevojshme teknike. Por, më shpesh përgjigjet fshihen diku tjetër, në sferën politike, në mungesën e përkrahjes efektive politike e sociale dhe në problemet e qeverisjes (World Bank, 1998).

Firmat Piramidale vs. Sistemit Bankar

Në vitet e para kur Shqipëria ndryshoi nga sistemi bankar socialist i vjetër, BSHSH u nda në bankën qendrore dhe në dy banka shtetërore të nivelit të dytë. Bankat e reja të krijuara ishin Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Banka e Kursimeve (BK) e cila doli si bankë prej Institutit të Arkave të Kursimit, kurse Banka Tregtare Agrare (BTA) nga Banka Bujqësore. Reforma nuk ishte shtrirë akoma në problemet e rënda drejtuese në sektorin bankar dhe të korporatave. Sistemi bankar po përballlej me të paktën tre probleme. Së pari, sektori ishte tepër i përqendruar. Ishin tre banka kryesore me pronësi shtetërore – BK, BKT dhe BTA – që dominonin sistemin bankar duke mbajtur 97 për qind të totalit të depozitave dhe 88 për qind të kredisë vendase në vitin 1996. Pjesa tjetër e sektorit bankar konsistonte në tre banka të vogla me kapital të huaj ose të përbashkët. Ato zhvilloheshin ngadalë dhe fokusoheshin kryesisht në transaksionet e shkëmbimit valutor dhe financimin e tregtisë.

Së dyti, tre bankat me pronësi shtetërore kishin humbje operative, dhe në të vërtetë ishin josolvente pasi ato kishin portofole me borxhe të këqija që rriteshin. Për shembull, BTA i jepte hua afatshkurtra fermerëve për blerjen e traktorëve e të kamionëve; në fund të vitit 1996 këto hua përbënin akoma një të tretën e totalit të huave të bankës dhe 80 për qind të borxheve të këqija (Jarvis, 2000). Huamarrësit shpesh i konsideronin borxhet nga bankat shtetërore sikur nuk kërkonin të riktheheshin. Gjithashtu, raporti shumë i ulët prej 11 për qind i huave mbi depozitat për të treja bankat reflektonte një nivel të ulët ndërmjetësimi nga bankat shtetërore në ekonomi.

Së treti, regjimi rregullator dhe mbikëqyrës ishte larg standardeve ndërkombëtare. Një pengesë serioze për zhvillimin e sektorit privat ishte zbatimi jorigoroz i ligjeve tregtare, ndërsa nënshtrimi ndaj rregullave duhej të ndërmerrej më strikt.

Përveç kësaj, sistemi i pagesave kishte gjithashtu probleme serioze. Deri në vitin 1996, koha mesatare për mbarimin e transaksioneve të pagesave ndërmjet llogarive në degë të ndryshme të të njëjtës bankë ishte 5-6 ditë, dhe koha që nevojitej për transaksionet që përfshinin llogari në banka shtetërore të ndryshme mund të ishte më shumë se dy javë (Jarvis, 2000). Gjithashtu, për shkak të shërbimeve bankare të varfra, depozituesve u duhej të shpenzonin orë të tëra vetëm për mbarimin e operacioneve të thjeshta bankare të tilla si tërheqje parash në dorë. Si rezultat i këtyre problemeve, dhe i një mosbesimi të përgjithshëm në banka, publiku preferonte të mbante një proporcion të lartë të aktiveve të tij financiare në *cash* dhe të kërkonte alternativa investuese të tjera.

Meqenëse bankat nuk ishin në gjendje të përmbushnin kërkesat për kredi të sektorit privat, një treg krediti joformal u zhvillua i bazuar në lidhjet familjare dhe i financuar më së shumti nga paratë e emigrantëve. Fillimisht, qeveria dhe vrojtuesit e huaj i toleruan firmat huadhënëse joformale pasi ato mendoheshin të jepnin një kontribut të rëndësishëm në ekonomi, derisa ato ishin ndoshta ndërmjetëuesit më të mirë për kursimet në Shqipëri, po të kemi parasysh mangësitë e tregut financiar formal.

Përveç tyre, ishin një numër firmash që merrnin borxhe në interesa të lartë, por i investonin në llogaritë e tyre, në vend që të jepnin hua. Shenjat e para të vendosjes së parave në këto firma u evidentuan që në vitin 1995 apo më herët se kaq. Njerëzit nuk ishin mjaft të kujdesshëm të bënin dallim nëse firmat kishin investime reale apo jo, dhe ata besonin se ato përkraheshin ose nga qeveria ose burimet e tyre vinin nga aktivitete ilegale që siguronin fitimet e tyre. Normat e larta të fitimit në këto firma "zëvendësuan" normat e interesit të ofruara nga bankat tregtare dhe si rezultat, politika monetare e bankës qendrore u bë më pak efektive. Ishin këto firma që më vonë u kthyen në skema piramidale, të cilat, në bazë të disa llogaritjeve të përafërta indirekte thithnin aq shumë sa 200-300 milionë dollarë amerikanë nga popullata (Cani, 1995). Ato nuk u licencuan kurrë të marrin depozita dhe nuk dihej nëse ato ishin ndonjëherë solvente.

Në krahun tjetër, politikat e ndjekura nga qeveria të udhëhiqnin në drejtime të gabuara. Disa zyrtarë qeveritarë përfitonin vetë dhe përkrahnin disa nga skemat kryesore, pasi ato në disa raste kontribuonin në fushatën e partisë në fuqi përpara zgjedhjeve në vitin 1996. Këto firma lejoheshin vazhdimisht të reklamonin në masmedia duke përfshirë TVSH, i cili transmetonte shpesh programe speciale duke ftuar anëtarë të qeverisë të siguronin konfidencën publike.

Për më tepër, strukturat legale të gjendura nga autoritetet për të luftuar firmat piramidale ishin plotësisht inadekuata. Kodi Civil lejonte firmat të merrnin hua, kështu që disa nga bizneset e licencuara pretendonin se ato operonin në përputhje me ligjin. Megjithatë, Banka e Shqipërisë kishte këmbëngulur se firmat huamarrëse po shkelnin ligjin mbi sistemin bankar, i cili përfshinte në veçanti se "asnjë person tjetër nga një bankë nuk do të

pranojë depozita kursimesh, dhe depozita me maturim fillestar prej 12 muajsh apo më pak" (Ligji nr. 8075, 22 shkurt 1996, neni 6). Por, autoritetet kompetente hezitonin të vinin në zbatim ligjin e ri dhe madje disa ishin të mendimit se ligji nuk zbatohet për firmat huamarrëse (Jarvis, 2000). Në përgjithësi, qeveria përpigëj të bënte dallim midis firmave me investime reale dhe piramidave "të pastra".

Në përfundim, është e rëndësishme të vërejmë se firmat piramidale nuk lindën dhe nuk u zhvilluan në gjirin e sistemit bankar. Bankat tregtare as nuk i përkrahën, e as nuk i justifikuan firmat. Përveç kësaj, banka qendrore paralajmëronte për rreziqet që mund të vinin nga skema të tilla. Megjithatë, duke patur parasysh hezitimin e organeve të tjera të qeverisë të lëviznin kundër firmave të fuqishme, dhe vështirësinë që Banka e Shqipërisë do të kishte hasur në zbatimin e ligjit kundër tyre, deficienca e saj është e kuptueshme.

III. HEMORAGJIA E DEPOZITAVE BANKARE NË MARS 2002

Tranzicioni drejt ekonomisë së tregut në Shqipëri, ashtu si në vendet e tjera në tranzicion ka kërkuar një ndryshim të konsiderueshëm të rolit të sektorit financiar. Sfida kryesore për politikëbërësit në këtë fushë ka qenë kapërcimi i difekteve të së kaluarës dhe në të njëjtën kohë dizenjimi dhe zhvillimi i një sistemi eficient të tregjeve dhe të institucioneve financiare. Sistemi financiar në Shqipëri, është dominuar kryesisht nga sistemi bankar, i cili siguron burime financimi në formë kredie për individët dhe për biznesin, që është në kërkim të kapitaleve qarkulluese. Këto institucione ofrojnë sasi relativisht të vogla të kapitaleve për t'u investuar, krahasuar me burimet e tjera të tilla si të ardhurat e aktivitetit dhe financat ndërkombëtare. Kjo është evidentuar nga raporti i ulët që zë totali i kredisë ndaj PBB-së (më pak se 5 për qind) duke demonstruar në këtë mënyrë një shkallë të ulët të depërtimit të shërbimeve financiare në ekonomi. Për rrjedhim, një numër i madh transaksionesh mbahet në *cash*, jashtë sporteleve të sistemit bankar.

Bankat vazhdojnë të dominojnë sistemin formal financiar, ndërkohë që shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë e kursim-kreditit zënë një pjesë të vogël. Ato financojnë qeverinë, kryesisht duke blerë bono thesari me maturitet një vit e poshtë. Megjithatë, bankat nuk janë burim i vetëm financiar për kapital qarkullues. Një vrojtim i mbajtur nga ekspertët e Bankës së Shqipërisë për investimet në gushtin e vitit 2000, tregon se më shumë se 90 për qind e bizneseve të mëdha në Shqipëri përdorin fitimet e tyre si burim primar të financimit, ndërkohë që vetëm 8 për qind përdorin forma të tjera financimi dhe vetëm 10 për qind kanë marrë hua nga sistemi bankar (Sh. Cani, M. Muço, T. Baleta, 2000). Rreth 3 për qind e bizneseve deklaroi se ata janë financuar nga kompani të tjera, dhe diçka më pak se 4 për qind e bizneseve marrin hua drejtpërdrejt nga individë duke përdorur çertifikatat e depozitave.

Në fund të vitit 2001, u regjistruan 13 banka në Shqipëri dhe 4 institucione financiare jobankare. Sistemi bankar është klasifikuar në 3 grupe: G1 i cili

konsiston në të vetmen bankë shtetërore, Bankën e Kursimeve, që s'ka mundur të privatizohet dhe vazhdon të dominojë sistemin bankar; G2 i cili konsiston në 2 banka me kapital të përbashkët të shtetit shqiptar me investitorë të huaj dhe G3 ku futen 10 bankat e mbetura private të cilat kontrollohen nga kapitali i huaj.

Përsa i takon strukturës së aktiveve të sistemit bankar, bankat vazhdojnë të investojnë në instrumente me rrezik zero ose me rrezik të ulët, ku sipas bilancit të 31 dhjetorit 2001, blerjet e bonove të thesarit përfaqësojnë 52 për qind, kreditë e dhëna 8 për qind dhe letrat e tjera me vlerë rreth 3 për qind të totalit të aktiveve. Pra duket se bankat kanë zgjedhur rrugët më të lehta për të siguruar fitime, në kushtet e një rreziku minimal. Në anën e pasiveve, depozitat tregojnë një ecuri në rritje gjatë vitit 2001 duke përbërë burimin kryesor të financimit të aktiviteteve bankare (84 për qind e aktiveve të sistemit bankar), ndërkohë që po sipas bilancit të 31 dhjetorit 2001, pjesëmarrjet e kapitalit aksioner u zvogëluan në 6 për qind të totalit të aktiveve krahasuar me 9 për qind një vit më parë, duke reflektuar një rritje të konfidencës publike mbi sistemin bankar.

Sistemi financiar në Shqipëri, përballet me vështirësi të ndryshme të cilat vazhdojnë ta mbajnë atë larg të qenurit eficient. Bankat hezitojnë në kreditimin e individëve dhe të shoqërive tregtare për shkak të problemeve të seleksionimit jo të favorshëm (rreziqet potenciale të kreditimit janë ato që tregohen më aktive në kërkimin e huave) dhe rrezikut moral (huamarrësi do të ndërmarrë aktivitete të cilat e ulin mundësinë se borxhi do të paguhet). Sistemi i drejtësisë në Shqipëri funksionon me shumë probleme, duke e bërë të vështirë përdorimin efektiv të instrumenteve që ndihmojnë në zgjidhjen e këtyre problemeve. Procedurat e falimentimit shpesh herë janë të ngadalta dhe shumë problematike. Për shembull, bankat duhet së pari të marrin hapa ligjorë ndaj debitorit për pagesën, veprim i cili mund të këkojë disa vjet, dhe më vonë pasi është bërë një gjykim i favorshëm, kreditorit i duhet të fillojë një tjetër proces ligjor, për të përfutur pronësinë mbi kolateralin. Prosesi i tërë mund të zgjasë mbi 5 vjet dhe me kalimin e kohës, kur banka do të marrë kolateralin ajo e ka "harruar" atë dhe sigurisht vlera e tij do të jetë më e ulët. Aty ku tregjet nuk janë të afta të përdorin kolateralet në mënyrë efektive, problemi i seleksionimit jo të favorshëm do të jetë më i rëndë për arsye se bankës do t'i nevojitet më tepër informacion rreth cilësisë së huamarrësit në mënyrë që të dallojë një borxh të keq nga një i mirë. Rezultati është që për bankat bëhet gjithnjë e më e vështirë që të kanalizojë fondet tek huamarrësit me mundësi më të mëdha produktive, duke bërë në këtë mënyrë që kreditimi i investimeve prodhuese të jetë më i vogël e për rrjedhim dhe rritja ekonomike të ngadalësohet.

Bankat luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm në sistemin financiar shqiptar pasi problemet në sektorin bankar mund të çojnë në kriza bankare, të rritin problemet e informacionit asimetrik i cili sjell kriza financiare. Veç kësaj, problemet në sektorin bankar i bëjnë krizat e shkëmbimeve valutore

më të mundshme, të cilat, duke dëmtuar bilancet jofinanciare, çojnë në një krizë të plotë financiare.

Një Shikim i Shpejtë në Kushtet Makroekonomike pas vitit 1997

Shumë studime janë bërë mbi modelet makroekonomike për të shërbyer si sisteme paralajmëruese të hershme për krizat bankare. Në përgjithësi, të dhënat e kërkuara për predikimin e krizave bankare janë një përzierje e ndryshoreve makroekonomike, çmimeve të aseteve dhe të dhënave të mbikëqyrjes. Si fillim, ne do të shikojmë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të cilët përcaktojnë luhatshmërinë e treguesve makroekonomikë si dhe kursin e këmbimit.

Shqipëria ka qenë e suksesshme në përpjekjet e saj drejt stabilizimit të treguesve makroekonomikë. Pas vitit 1997, kur prodhimi i brendshëm bruto ra në nivelet e atij të vitit 1992, ky tregues u përmirësua ndjeshëm në katër vitet e fundit duke u rritur me 7.4 për qind në vit në terma realë. Kjo rritje i detyrohet kryesisht rimëkëmbjes së shpejtë të sektorëve të ndërtimit dhe të transportit, të cilët u dëmtuan rëndë gjatë trazirave të vitit 1997.

Impresionuese është edhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve në vend. Ndonëse ecuria e inflacionit në Shqipëri ka qenë e ngjashme me atë të vendeve të tjera në tranzicion, normat e tij kanë qenë në përgjithësi në nivele të ulëta. Pas rënies së skemave piramidale në vitin 1997, autoritetet e vendit ishin në gjendje të rifitonin kontrollin mbi kushtet ekonomike nëpërmjet zbatimit të politikave të forta stabilizuese, përfshirë edhe një politikë të shtrënguar monetare. Norma e inflacionit ra në 8.7 për qind në vitin 1998; ajo arriti nivelin më të ulët në dhjetë vjet në vitin 1999 duke rezultuar -1 për qind; dhe më pas kjo normë u stabilizua duke arritur nivelet 4.2 dhe 3.5 për qind përkatësisht në vitet 2000 dhe 2001.

Banka e Shqipërisë ka adoptuar një regjim të politikës monetare, objektiv kryesor i së cilës është mbajtja e përqindjes vjetore të inflacionit brenda intervalit 2 – 4 për qind, një përqindje kjo e ulët kur i referohemi standardeve të vendeve në zhvillim. Politika monetare ka qenë përgjithësisht konservatore dhe fakti që inflacioni vazhdon të jetë i ulët është një evidencë e efektivitetit të kësaj politikë të Bankës së Shqipërisë. Megjithatë nuk mund të thuhet se më në fund Banka e Shqipërisë ka fituar besimin e plotë të publikut, dhe kjo sepse shpesh herë inflacioni shmanget nga intervali objektiv, kryesisht për shkak të faktorëve të paparashikuar dhe të atyre spekulative të cilët në shumicën e rasteve janë jashtë kontrollit të Bankës së Shqipërisë.

Edhe zhvillimet fiskale kanë njohur një ecuri pozitive sidomos pas përkeqësimit të madh të vitit 1997. Deficiti buxhetor, i cili arriti në rreth 13 për qind të PBB-së gjatë periudhës 1996 – '97, ka shënuar rënie të njëpasnjëshme për të arritur në 8.5 për qind të PBB-së në fund të vitit 2001. Megjithatë, pavarësisht këtyre përpjekjeve, operacionet ekstrabuxhetore dhe ato pothuajse fiskale, akoma llogariten të zënë një përqindje të lartë të

financave publike duke bërë kështu që deficitin fiskal të jetë ende i konsiderueshëm.

Është i njohur fakti se statistikat e punësimit në Shqipëri janë të nënvleftësuar. Krahu i punës i pashpresë dhe ata të punësuar në sektorin informal të ekonomisë, akoma vazhdojnë të numërojnë një numër të lartë të fuqisë së aftë për punë. Disa probleme shtesë mund të shfaqen, gjithashtu, përgjatë procesit të privatizimit dhe të ristrukturimit të pronës publike, një fazë kjo që është kryer me herët nga vendet e tjera. Megjithatë rritja e fortë ekonomike e viteve të fundit, ka pasur një ndikim pozitiv mbi zvogëlimin e

| Trendi i Rritjes Ekonomike dhe Ekuilibrit Makroekonomik në Ekonominë Shqiptare pas Tranzicionit | | | | | | | | | | |
|--|-------|--------|-------|-------|-------|--------|--------|-------|--------|--------|
| | 1992 | 1993 | 1994 | 1995 | 1996 | 1997 | 1998 | 1999 | 2000 | 2001 |
| Rritja e PBB, çmimet e 1990 (in %) | -7.2 | 9.6 | 9.4 | 8.9 | 9.1 | -7.0 | 8.0 | 7.3 | 7.8 | 6.5 |
| Norma vjetore e inflacionit | 236.6 | 30.9 | 15.8 | 6.0 | 17.4 | 42.1 | 8.7 | -1 | 4.2 | 3.5 |
| Përqindja e papunësisë | ... | 22.3 | 18.4 | 13.1 | 12.4 | 14.9 | 17.8 | 18.2 | 16.8 | 14.6 |
| Raporti i Bilancit fiskal/PBB (në %) | -21.3 | -13.7 | -9.0 | -10.2 | -12.8 | -12.9 | -10.4 | -11.5 | -9.3 | -8.5 |
| *Raporti i Llogarisë korente/PBB (%) | ... | ... | -14.3 | -9.7 | -11.5 | -14.4 | -8.2 | -7.2 | -7.0 | -7.4 |
| Ndihmat e huaja (në milionë US\$) | ... | 303.9 | 117.2 | 128.5 | 83.4 | 29.0 | 82.6 | 165.0 | 94.4 | 28.1 |
| Transferrat private (në milionë US\$) | ... | 324.1 | 374.1 | 348.9 | 476 | 235.7 | 421.3 | 188.4 | 438.6 | 542.7 |
| Rezervat e huaja/importet mujore (%) | 0.52 | 2.37 | 3.5 | 3.65 | 3.14 | 4.63 | 4.88 | 5.23 | 4.85 | 4.92 |
| Lek/US\$ (mesatarja vjetore) | 75.03 | 102.06 | 94.68 | 92.79 | 104.5 | 148.93 | 150.64 | 137.7 | 143.71 | 143.48 |

përqindjes së papunësisë, e cila nga 18 për qind në vitin 1998 ka zbritur poshtë nivelit 15 për qind në fund të vitit 2001.

Në të vërtetë, një zhvillim problematik përbën ecuria e bilancit të llogarisë korente. Shqipëria ka përjetuar në mënyrë të vazhdueshme deficite në llogarinë korente duke filluar që nga viti i parë i tranzicionit dhe duke kulmuar në vitin 1997 me 14.4 për qind të PBB-së. Më tej ky deficit është zvogëluar duke qëndruar në terma mesatarë në nivelin 7.2 për qind për të 3 vitet e fundit. Megjithatë është e vështirë të konkludosh se përmasat e deficiteve të llogarisë korente ndikojnë në uljen e besimit të depozituesve apo jo. Ashtu siç duket edhe në tabelën e mësipërme, të ardhurat nga emigracioni kanë qenë decizive në balancimin e pozicionit të përgjithshëm të bilancit të pagesave dhe në stabilizimin e kursit të këmbimit. Pasi humbi rreth gjysmën e vlerës së tij,

në periudhën e kolapsit të vitit 1997, Leku shqiptar rikuperoi ndjeshëm kundrejt dollarit amerikan, dhe këto vitet e fundit ka qëndruar brenda intervalit të pritshëm të llogaritur nga Banka e Shqipërisë.

Megjithatë, është e dukshme që tërheqja e depozitave në muajt mars dhe prill 2002, nuk pasqyrore kushtet aktuale makroekonomike. Ndërsa ecuria makroekonomike e Shqipërisë ka qenë inkurajuese, ekonomia ende vazhdon të mbetet relativisht e vogël dhe akoma më shumë duhet bërë. Ekzistojnë faktorë të tjerë që ndikojnë performancën e ekonomisë, të tillë si prania e tregut informal, mungesa e bazës së plotë ligjore dhe rregullatore (sidomos zbatimit të tyre) etj..

Ecuria e Sektorit Bankar: Nevoja për reforma

Ndërsa stabiliteti ekonomik është parë si një parakusht i rëndësishëm për shëndetin bankar, kërcënimet e fundit ndaj sektorit bankar kanë treguar se shëndeti i sektorit financiar mund të ketë implikime negative serioze që destabilizojnë pjesën tjetër të ekonomisë. Bankat vazhdojnë të shihen si komponenti më i rëndësishëm i sektorit financiar për shkak të rolit të tyre në transmissin e politikës monetare, 'si ruajtëse të likuiditetit, si mekanizmi qendror i sistemit të pagesave dhe si burimi parësor i financimit...'¹. Kjo e fundit është e vërtetë veçanërisht për Shqipërinë ku tregu i kapitaleve është shumë pak i zhvilluar dhe sektori bankar vazhdon të përfshijë shumicën e aseteve të sistemit financiar.

Pasi ndoqëm treguesit makroekonomikë në parashikimin e krizave bankare, tani le të hetojmë të dhënat nga pasqyrat financiare të bankave, veçanërisht *kapitali bankar, cilësia e aseteve, fitimet dhe treguesit e likuiditetit*.

Zvogëlimi i mjaftueshmërisë së kapitalit të institucioneve financiare ka qenë njëra nga karakteristikat e identikuara me 14 nga 22 episode financiare ndërkombëtare të studiuara (Davis E P, 1999) dhe kjo mund të shërbejë si një tregues i hershëm i krizave. Prandaj, bankat duhet të marrin vendime rreth sasisë së kapitalit që ato kanë nevojë të mbajnë. Në fakt, kapitali bankar ndihmon në parandalimin e falimentimit bankar, kështu që bankat mbajnë një nivel të lartë kapitali me qëllim uljen e shansit që të bëhen insolvente. Megjithëse kapitali bankar është i kushtueshëm sepse sa më i lartë të jetë aq më e ulët do të jetë kthyeshmëria nga kapitali i aksionerëve, administratorët e bankave në Shqipëri kanë mbajtur një raport të lartë të kapitalit shumë më sipër se 12 për qind, që është minimumi i kërkuar i vendosur nga Banka e Shqipërisë. Prandaj, raporti i kapitalit për bankat me pronësi shtetërore (G1) është rritur nga negative 10 për qind në shtator 2000 deri në rreth 30 për qind në fund të vitit 2001. Bankat me kapital të përbashkët (G2) e, edhe ato private (G3) kanë mbajtur një raport të kapitalit prej afro tre herë më shumë se minimumi i kërkuar përgjatë gjithë vitit 2001. Nga ky këndvështrim, sistemi bankar mund të besohet si i siguruar dhe si i pangjashëm për të falimentuar.

¹ Nga E.A.J. George, *Are Banks Still Special?* IMF, 1997

Të dhënat e mbikëqyrjes për të cilat është treguar më tepër interes janë treguesit e cilësisë së aseteve – domethënë, *borxhet e këqija* (NPL) të mbartura nga bankat në bilancin e tyre dhe *provigjonet e mbajtura nga bankat kundër humbjeve nga borxhet*. Nivelet e larta të NPL-ve dhe provigjonet joadekuate mund të kenë ndikim të ashpër në rentabilitetin, e përfundimisht në aftësinë e pagimit, të sistemit bankar. Në maksimizimin e fitimit, një bankë duhet të kërkojë njëherësh të ardhurat më të larta mbi borxhet dhe letrat me vlerë, të zvogëlojë rrezikun, dhe të mbajë provigjone adekuate likuiditeti duke mbajtur asete likuide. Megjithëse raporti i borxheve të këqija ndaj totalit të huave në sistemin bankar ka qenë relativisht i lartë (rreth 11.6 për qind në dhjetor 2001), ai nuk përbënte ndonjë kërcënim paaftësie paguese. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht si rezultat i një raporti të ulët të totalit të huave ndaj totalit të aseteve. Dhe, në veçanti nëse shohim Bankën e Kursimeve dhe Bankën Kombëtare Tregtare – dy bankat më të mëdha që vuajtën më tepër nga tërheqja e depozitave në mars dhe në prill – huatë e tyre ishin më pak se gjysmë për qind e aseteve totale në fund të vitit 2001. Me fjalë të tjera, ato nuk ishin të ekspozuara ndaj frikës së një falimentimi të mundshëm për shkak të rrezikut të kreditit.

Veç kësaj, të dhënat mbi përbërjen e aseteve dhe strukturës së pasiveve që tregojnë likuiditetin relativ të tyre duken se e provojnë argumentin e mësipërm. Dy muaj përpara tërheqjes së madhe të depozitave, asetet likuide në sistemin bankar formonin afërsisht 90 për qind të aseteve totale, ku më shumë se gjysma e tyre ishin të investuara në bonot e thesarit. Gjithashtu, detyrimet afatshkurtra përbënin rreth 95 për qind të detyrimeve totale, dhe raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve totale afatshkurtra ishte mbi 98 për qind. Në këtë mënyrë, të gjitha detyrimet ishin në parim të mbuluara nga asetet, të cilat mund të ktheheshin shpejt në *cash* kurdo që të kërkohej një likuidim. Për më tepër, të gjitha asetet e Bankës së Kursimeve ishin praktikisht likuide dhe nuk kishte asnjë arsye, përveçse spekulative, që të besojë se ajo do të ishte e paaftë për të paguar.

Treguesit e të ardhurave janë, gjithashtu, me interes të veçantë sepse ato mund të çojnë në vlerësimin e ecurisë së kaluar të bankës dhe të kapacitetit për të paguar depozituesit dhe detyrimet e tjera të saj në të ardhmën. Në vlerësimin e cilësisë së të ardhurave është e dobishme të shihen raportet e fitimeve, të tilla si kthyeshmëria e aseteve (KEA) dhe kthyeshmëria e kapitalit të aksionerëve (KKA). KEA jep informatë mbi atë se sa eficient ka qenë administrimi i një banke sepse ajo tregon se sa fitime janë nxjerrë mesatarisht për çdo lek të aseteve. Pasi pësuan humbje të mëdha në vitet përpara 1999, sistemi bankar shqiptar ka ecur mirë gjatë dy viteve të kaluara. KEA për të gjitha bankat ishte 2.1 për qind dhe 1.5 për qind në dhjetor 2000 dhe 2001 përkatësisht. Kjo do të thotë se për çdo 100 milionë lekë asete, sistemi bankar në tërësi po nxirrte një fitim neto mbas taksave prej 2.1 milionë lekësh në vitin 2000 dhe 1.5 milionë lekësh në vitin 2001. I njëjti argument ndjek edhe për kthyeshmërinë e kapitalit të aksionerëve, ku bankat private (G3) duket se kanë ecur më mirë në dy vitet e kaluara. Fitimi neto pas

taksave për çdo lek të kapitalit aksioner për G3 në dhjetor 2001 ishte gati katër herë më shumë se e njëjta periudhë në vitin 2000.

Në të vërtetë, disa tregues të ecurisë së këtij sektori në periudhën 1998-2001, duke përfshirë fitimin parataksës, KEA dhe KKA, marxhinën neto të interesit dhe kostot e operimit, të çojnë në konkluzionin se rehabilitimi i suksesshëm i bankave ka kontribuar në shëndetin e përmirësuar financiar të sektorit bankar në tërësi.

Megjithatë, edhe pse cilësia e aseteve dhe ecuria financiare e bankave shqiptare është përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit, sektori bankar i vendit po përballet me një numër problemesh dhe sfidash aktuale e potenciale. Ato kanë një karakteristikë të përbashkët që është mungesa e aktiviteteve ristrukturuese të bankave, që nevojitet për ndreqjen e tyre efektive ndaj sfidave të liberalizimit të shërbimeve financiare ndërkombëtare. Pavarësisht nga numri relativisht i madh i bankave në Shqipëri, tregu vazhdon të karakterizohet nga përqendrimi i lartë dhe shkalla e ulët e konkurrencës (në fund të vitit 2001, dy bankat kryesore përbënin afërsisht 70 për qind të aseteve totale të sektorit bankar). Edhe pse ligji "Për konkurrencën" është miratuar në Shqipëri që prej vitit 1995, përpjekjet për të hedhur dritë mbi dispozitat e këtij ligji kanë qenë të luhatura. Veç kësaj, dominimi i Bankës së Kursimeve ka sjellë konsekuenca kritike e influencuese në sistemin bankar: kjo e ka bërë të vështirë për Bankën e Shqipërisë të zbatojë me efikasitet politikën e saj në instrumentet indirekte; ajo ka patur vazhdimisht një ndikim të rëndësishëm mbi administrimin e borxhit të brendshëm, në normën e *yield*-it të bonove të thesarit dhe në operacionet e tregut të hapur; gjithashtu ajo ka qenë pengesë për prezantimin e produkteve të reja financiare në sektorin bankar për shkak të mungesës së konkurrencës etj. etj. (Baleta, Kallfa, File, Baholli, Bokshi, Abazi, 2000). Në ofrimin e shërbimeve të tyre ndaj sektorit privat, shumica e bankave vazhdojnë t'i kufizojnë aktivitetet e tyre në shërbimet klasike bankare ndërkohë që produkte dhe shërbime më të sofistikuara, të tilla si investime bankare, janë në hapa fillestarë zhvillimi.

Për këtë arsye, ka nevojë të madhe për orientimin e politikave në përmbushjen e reformave në sektorin bankar në Shqipëri. Objektivi kryesor i këtyre reformave është rritja e konkurrencës ndërkombëtare e sektorit në një nivel që do të lejonte integrimin e suksesshëm financiar jo vetëm në tregun rajonal për shërbimet financiare por, gjithashtu, edhe në Bashkimin Evropian. Kërkesat e hyrjes në BE për sektorin bankar janë një nxitje e rëndësishme drejt reformave që do të sjellin bankat shqiptare në përputhje me standardet perëndimore. Këto reforma duhet të bëhen përfundimisht edhe nëse vendi hyn në BE apo jo.

Masat politike për arritjen e objektivave të pohuar në sektorin bankar mund të klasifikohen në tre grupet e mëposhtme: *(i) ristrukturimi i brendshëm dhe konkurrenca*: kjo përfshin privatizimin e bankës shtetërore, e cila shpesh ka qenë shkaku parësor i vështirësive të sektorit bankar dhe në përgjithësi është vërejtur me operate më pak eficiente; dhe ristrukturimi i brendshëm i

bankave me qëllim uljen e kostove operacionale dhe zgjerimin e shtrirjes së shërbimeve në një treg më kompetitiv.

(ii) Rregullimi dhe mbikëqyrja bankare: për të përmirësuar kuadrin mbikëqyrës, banka qendrore ka përcaktuar disa objektiva si: përmirësimi i drejtimit financiar të bankave, fuqizimi i mbikëqyrjes bankare dhe promovimi i një ambienti të shëndoshë bankar. Në fakt, bankat janë ndër institucionet financiare më të rregulluara në vend. Duke u nisur nga efektet e dëmshme që mund të ketë paniku bankar, Parlamenti Shqiptar, në 29 mars 2002, miratoi ligjin "Për sigurimin e depozitave". Sipas këtij ligji depozituesve iu paguhet tërësisht 350'000 lekshi i parë nga vlera e depozitës (afërsisht 2500 usd) dhe 85 për qind e 350'000 lekshit të dytë. Për këtë arsye, së shpejti pritet të ngrihet Agjencia e Sigurimit të Depozitave, roli i së cilës është promovimi i stabilitetit të sistemit financiar dhe i besimit të publikut në institucionet financiare vendase. Me depozita të siguruara depozituesit nuk kanë arsye të nxitojnë për të tërhequr depozitat e tyre sepse ato do të paguhen qoftë edhe në një kohë të dytë.

Në anën tjetër, duke qenë se sigurimi i depozitave mund të rritë stimujt e angazhimit të tepërt në aktivitete me rrezik, banka qendrore i ka kushtuar vëmendje të veçantë krijimit dhe funksionimit të një sistemi rregullator dhe mbikëqyrës të tillë që të kufizojë marrjen përsipër të një rreziku të lartë nga sistemi financiar. Rregullat dhe rregulloret janë përgjithësisht sipas standardeve ndërkombëtare dhe kontrollet zhvillohen rregullisht. Mbikëqyrja e sistemit bankar është përmirësuar ndjeshëm, pas kolapsit të skemave piramidale në vitin 1997, për të garantuar respektimin e vazhdueshëm të ligjit dhe për të zbuluar shkeljet e ligjit bankar. Sidoqoftë, zhvillimi i sistemit bankar ka ecur më shpejt se zhvillimi i kuadrit rregullator bankar. Diversifikimi i fundit i aktiviteteve bankare e bën të nevojshëm fuqizimin e teknikave të mbikëqyrjes dhe teknikave moderne të administrimit të rrezikut nga ana e bankave tregtare (Volker Treichel, 2001).

(iii) Përafrimi ligjor me legjislacionin e BE-së: edhe pse ligji për bankat është një hap i rëndësishëm përpara, ka akoma nevojë për një përafrim të mëtejshëm me legjislacionin bankar të BE. Për t'u bërë anëtar i Unionit kërkohet që vendet candidate të drejtojnë sistemet kombëtare ligjore me legjislacionin ekzistues të BE në të gjitha fushat – një drejtim i plotë i legjislacionit të mjedisit kombëtar dhe sistemit korrespondues administrativ. Të arrish këtë do të thotë, mbi të gjitha, se Shqipëria duhet të bëjë më tepër sesa vënien e vizës thjesht në kutitë e *acquis communautaire* – grupi i ligjeve që vendet candidate duhet të adoptojnë për t'u pranuar.

Shkaqet dhe pasojat e rrjedhjes së depozitave: Kriza e konfidencës

Rrjedhja alarmante e depozitave në muajt mars dhe prill mund të jetë një tjetër shembull i iracionalitetit që karakterizon herë pas here tregun financiar shqiptar.

Paniku i bankave, i shkaktuar kryesisht nga mungesa e informacionit dhe e njohjes së sistemit financiar nga ana e depozituesve, tregoi edhe një herë sesa i pambrojtur dhe i ndikueshëm është ky sistem nga lëvizjet spekulative dhe sa skeptik është publiku për sa i përket respektimit të detyrimeve nga ana e qeverisë. Kjo mund të jetë edhe arsyeja që shpjegimet e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dhe të Ministrit të Financave nuk patën efektin e menjëhershëm stabilizues që pritej.

Deklarata e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë e 27 shkurtit 2002 mbi "Kërcënimet ndaj stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri" e vlerësonte sistemin bankar si të qëndrueshëm, duke u bazuar në normat e fitimit, në administrimin e kapitalit dhe në cilësinë e shportës së kredive. Nga ana tjetër, panorama ekonomike ishte mjaftueshëm optimiste. Sidoqoftë, pozitiviteti i arsyeve ekonomike u përmbys nga një sërë pasigurish politike, që buruan nga dyshimet mbi ligjin e ri "Mbi sigurimin e depozitave", shtesë e ligjit "Mbi kompensimin e pronarëve" dhe procesi i privatizimit të Bankës së Kursimeve që filloi menjëherë para miratimit të këtij ligji.

Paniku që nisi në mars bashkë me procesin e privatizimit të bankës së mbetur pronë e shtetit solli tërheqje masive depozitash nga kjo bankë. Me uljen e menjëherëshme të depozitave shpërtheu një panik financiar dhe një krizë konfidence filloi të përhapej në gjithë sistemin bankar. Rrjedhjet e depozitave nga dy bankat më të mëdha, Banka e Kursimeve dhe Banka Kombëtare Tregtare, arritën në 12.1 miliardë lekë në mars dhe 9.4 miliardë lekë në prill. Pesha më madhe e rrjedhjeve ra mbi Bankën e Kursimeve (96.3 për qind), gjë që solli uljen e peshës së kësaj banke në sistemin bankar me 1.5 për qind. Sidoqoftë, fakti që rrjedhjet e depozitave nisën me bankën më të madhe të sistemit në prag të privatizimit të saj e bën analizën e mësipërme më pak të qartë dhe gjithësesi të hapur ndaj arsyetimeve dhe spekulimeve të ndryshme.

Si rezultat i uljes së depozitave, oferta e parasë në muajin mars u ul me rreth 4.5 miliardë lekë dhe paraja jashtë bankave u rrit më tepër se 10 miliardë lekë. Tërheqjet e depozitave sollën probleme likuiditeti për bankat e nivelit të dytë. Në përgjigje të situatës së krijuar, Banka e Shqipërisë e zhvendosi kursin e politikës monetare dhe luajti rolin e injektuesit të likuiditetit në treg. Në muajin mars, Banka e Shqipërisë injektoi në treg rreth 6.4 miliardë lekë për të ndihmuar bankat e nivelit të dytë të respektonin detyrimet e tyre ndaj depozitorëve. Rëndimi i situatës së likuiditetit krijoi, gjithashtu, probleme në financimin e deficitit buxhetor. Nga 1 marsi deri në 24 maj krediti total i Bankës së Shqipërisë ndaj qeverisë arriti në 6 miliardë lekë, duke pasur si qëllim, përveç përmbushjes së nevojave të qeverisë edhe lehtësimin e peshës së Bankës së Kursimeve në financimin e borxhit shtetëror nëpërmjet investimit në bonot e thesarit. Në mënyrë të ngjashme, përqindjet e interesave të *repove* u rritën me 1 për qind duke pasur si qëllim shmangien e presionit mbi inflacionin dhe kursin e këmbimit, si dhe parandalimin e rrjedhjes së mëtejshme të depozitave. Rritja e përqindjes së interesave nga ana e Bankës së Shqipërisë dhe mungesa e likuiditetit në treg sollën rritjen e përqindjes së interesave të depozitave të bankave të nivelit të dytë si dhe të

bonove të thesarit. Sidoqoftë, duhet thënë se kriza gjatë gjithë kohës ishte nën kontroll dhe u administrua mirë nga ana e Bankës së Shqipërisë. Një tregues i kësaj është fakti që besimi në monedhën vendase nuk u lëkund dhe qëndrueshmëria e kësaj monedhe u reflektua në qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit.

Janë disa arsye për tu shikuar pas krizave të depozitave. Aktualisht nuk mund të thuhet me siguri që ndonjëra prej tyre të ishte aq e rëndësishme për të pasur efekte negative potenciale për ta bërë këtë krizë kaq serioze, por ato vetëm ndihmuan në këtë krizë. Në shkurt, Parlamenti Shqiptar diskutoi çështjen e sigurimit të depozitave dhe një ligj do vinte si rrjedhim në një kohë të shkurtër. Në të njëjtën kohë, vazhdonin takimet në Gjermani, Itali, Austri, Greqi, Zvicër etj., për privatizimin e Bankës së Kursimeve. Megjithëse ligji i ri për sigurimin e depozitave kishte për qëllim mbrojtjen e depozitorëve bankar vendas, mënyra si u paraqit nga politikanët dha sinjale konfuzioni tek depozitorët, të cilët duke treguar interes në privatizimin e Bankës së Kursimeve dyshuan dhe e keqinterpretuan ligjin.

Shqiptarët kanë kohë që i shikojnë me skepticizëm fjalët dhe premtimet e qeverisë së tyre. Populli ishte i pakënaqur nga papërgjegjësia e administratës në fillim në vitin 1992, kur Shqipëria u largua nga sistemi bankar socialist, dhe pastaj kur kursimet e tyre të akumuluarra për disa vite me rradhë u humbën si rrjedhim i çmimeve të larta dhe i një monedhe vendase të mposhtur. Izolimi i Shqipërisë dhe mosnjohja nga ana e popullatës me ekonominë e tregut e forcojnë këtë argument. Humbja e kursimeve shkaktoi shumë probleme dhe vuajtje duke pasur parasysh se sa e vështirë ishte të lije para mënjanë gjatë kohës së regjimit komunist.

Një tjetër ndodhi që goditi konfidencën e publikut – siç e kemi diskutuar më sipër në këtë shkrim – ishte kolapsi i skemave piramidale në vitin 1997, që i bëri masat të dilnit jashtë kontrollit duke rrëzuar qeverinë e Partisë Demokratike dhe duke e zhytur Shqipërinë në anarki. Disa nga anëtarët e qeverisë, të nisur nga përfitimet prej skemave të investimit piramidale u munduan t'i bindin njerëzit për sigurinë e depozitave të tyre, dhe as që e morën mundimin të shikonin në ishin të sigurta apo jo në të vërtetë. Konfuzioni dhe kaosi i vitit 1997 ka lënë gjurmë në mendjen e njerëzve edhe sot, pas më shumë se gjysmë deкаде, duke dëmtuar besimin në një administratë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme.

Duke u kthyer në shkaqet e hemoragjisë të depozitave bankare të mars – prill, deklarimi i kryeministrit për përmisimin e ligjit në kompensimin e pronarëve në shkurt, stimuloi krizat dhe problemet. Mënyra se si qeveria do t'i kompensonte ishte lënë e paqartë; ishte i panjohur fakti se nga do vinin këto fonde dhe a do të çonin këto në inflacionin dhe rënien e lekut. Megjithëse ky argument mund të tingëllojë i dobët, ai bën thirrje për transparencë më të madhe dhe rritje të përgjegjësisë politike. Korrupsioni në të gjitha nivelet e administratës ka qenë pengesa më e madhe e ekonomisë shqiptare dhe e zhvillimit social. Sipërmarrjet e qeverisë për luftimin e korrupsionit – të nxitura

deri diku edhe nga agjencitë ndërkombëtare – janë akoma të ndikuara negativisht prej disa përfshirjeve politike në lidhje jo të qarta. Gjithashtu, zgjedhjet e shpeshta dhe gjendja politike e rënduar i ka mbajtur larg investitorët e huaj dhe ka interferuar në privatizimin e Bankës së Kursimeve dhe të ndërmarrjeve të tjera publike. Ky mund të jetë momenti që trupi politik të bëjë më shumë për të rifituar konfidencën e publikut. Por si? Deklarimet nuk kanë funksionuar. Është koha që veprat të flasin më shumë se fjalët.

IV. VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Fenomeni i skemës piramidale nuk është zhvilluar vetëm në Shqipëri. Dekada e fundit ka vëzhguar lindjen e tyre edhe në vendet e tjera në tranzicion, si MMM në Rusi, Caritas në Rumani dhe skema të vogla në Bullgari dhe në Republikën Çeke. Shkaku i përbashkët që çoi në ngritjen e skemave në këto vende ishte sistemi bankar joadekuat, një sistem legal i paqartë, mungesa e përgjegjësisë dhe qeveritë joentuziaste ose të ngadalta në zgjidhjen e problemit.

Shkatërrimi i papritur i skemave të tilla u ndoq nga disintegroimi ekonomik dhe social. Shumë njerëz humbën punën e tyre dhe problemet e varfërisë dhe të pabarazisë së të ardhurave u përkeqësua me vrull. Një pjesë e konsiderueshme e përmirësimit në standardin e jetesës që ishte akumuluar në vitet e mëparshme avulloi në pak muaj.

Analogjia më e përafërt me të tilla skema është fluska e aseteve, ndikimi ekonomik i të cilave ishte për shkak të ndryshimeve në pasurinë sipërfaqësore (Jarvis, 2000). Njerëzit besonin se ishin më mirë sesa ato ishin në realitet. Kërkesat për të mira dhe para i tejkaluan kufijtë, të cilat, në mungesë të kapacitetit prodhues vendas çuan në një fluks të pazakontë të importeve të të mirave duke përfshirë edhe ato luksoze. Mbasi fluska shpërtheu, pasuria sipërfaqësore ra dramatikisht. Një tjetër veçori e fenomenit të skemave piramidale është se qeveritë ndihmuan në përkeqësimin e gjendjes duke inkurajuar njerëzit të futnin më shumë para në skemat, dhe së bashku me zgjerimin e defiçitit buxhetor, rritën ofertën e parave dhe krijuan iluzionin e një shoqërie me konsumim të pakufizuar, që rezultoi në inflacionin e vitit 1996 tre herë më të lartë se ato të viteve të mëparshme. Megjithatë, këto karakteristika nuk u panë përpara tërheqjes së depozitave në mars të këtij viti. Politika monetare dhe fiskale ka qenë e shtrënguar gjatë viteve të fundit, në mënyrë që të krijohej atmosfera e duhur ekonomike për një zhvillim të qëndrueshëm, për ristrukturimin e ekonomisë, për privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha dhe të sektorëve strategjikë, dhe inkurajimin e zhvillimit të sistemit financiar.

Për më tepër, deri në mes të viteve '90 sistemi bankar ishte joadekuat. Bankat kishin humbje operative dhe ishin në realitet të paafta për të paguar

pasi kishin portofole me hua të këqija në rritje. Gjithashtu, sistemi i rregullimit dhe i mbikëqyrjes qëndronte shumë larg standardeve ndërkombëtare. Zhvillimi i sektorëve pengohej nga zbatimi i papërshtatshme të ligjit të tregtisë, ndërsa zbatimi i rregulloreve duhej të kryhej më me rigorozitet. Në të kundërt, bankat kanë operuar shumë më mirë këto vitet e fundit, dhe në të njëjtën kohë ato kanë mbajtur një nivel të lartë të kapitalit për të parandaluar falimentimet e tyre. Megjithëse jo shumë të diversifikuara, cilësia e asetëve duket relativisht e qëndrueshme dhe në përgjithësi sistemi bankar ka pasur një ekspozim të kufizuar të rrezikut të kreditit. Gjithashtu, sistemi është i siguruar për sa kohë që bankat mbajnë pozitën e tyre të hapur në monedhën e huaj brenda kufijve dhe mundohen të minimizojnë ekspozimin ndaj rrezikut të normave të interesit.

Megjithatë, ekperiencia e tanishme konfirmon edhe një herë mosnjohjen nga popullata me institutet e tregut dhe nevojën për të edukuar publikun shqiptar me problemet e natyrës ekonomike e financiare në mënyrë që të parandalohet ekspozimi ndaj spekulimeve të ardhshme. Pamundësia për të mësuar nëse administruesit e bankave po ndërmarrin rrezik të madh apo janë spekulantë, i bën depozituesit të jenë të pasigurtë për të futur paratë e tyre në banka, duke i bërë kështu institucionet bankare më pak praktike. Veç kësaj, mungesës së informacionit nga ana e deposituesve rreth cilësisë së asetëve bankare mund të çojë në panik bankar, i cili mund të ketë pasoja ekonomike të dëmshme. Në një kohë të tronditjes së konfidencave në bankat tregtare, Banka e Shqipërisë duhet të punojë për përmirësimin e imazhit të saj përpara publikut dhe të sigurojë mbështetjen e investitorëve duke qenë më transparente për rolin dhe përgjegjësitë e saj. Përgjegjësia është thelbësore pasi reagimi i publikut shpesh mund t'i përkeqësojë gjërat para se të përmirësohen. Kjo na kujton se psikologjia e tregut shpesh mund të jetë më e rëndësishme se themelet positive. Nëse nuk bëhet asgjë për të rifituar konfidencën e publikut, paniku bankar mund të shfaqet pa paralajmëruar.

Referenca:

1. World Bank, *Albania Beyond Crisis*, 1998
2. Jarvis, C., *The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania*, IMF, vol.47, no.1, 2000
3. Cani, S., *Financial Reforms in Albania*, 1995
4. Morris Goldstein & Phillip Turner, *Banking Crisis in Emerging Economies: Origins and Policy Options*, BIS, 1996
5. Davis E P, *A Reappraisal of Market Liquidity Risk in the Ęake of Russia/LTCM Episode*, 1999
6. Frederic S. Mishkin, *The Economics of Money, Banking, and Financial Markets*, 5th ed., 1998
7. CCBS, *Financial Market Data for International Financial Stability*, June 1999
8. Cani, Sh., Muço, M., Baleta, T., *Sistemi Bankar në Shqipëri*, Gusht 2000
9. Mojmir Mrak, *Ekonomický Ęasopis: Restructuring of the Banking Sector in Slovenia in View of its Accession to the European Union*, vol. 47, no. 2, 1999
10. Baleta, T., Kallfa, N., File, L., Baholli, F., Bokshi, S., Abazi, E., *Dominimi i Tregut Bankar Shqiptar*, Shtator 2000
11. Volker Treichel, *Stabilization Policies and Structural Reforms in Albania Since 1997*, IMF, 2001
12. BoA, *Programi monetar i BSH per vitin 2002*, 2002
13. Redaktuar nga Hodess, R., Banfield, J., & Wolfe, T., *Global Corruption Report 2001*, Transparency International, 2001